



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, LETRAVE DHE
PLATFORMËS SË BASHKËQEVERISJES**

Nr. 12291/ 1 prot.

Tiranë, më 24.12.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. Tefta Bregasi

Adresa: Lagjja “Bishanakë”, Pall ETC, Fier

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 12291 Prot., datë 10.12.2024 lidhur me përfitimin sipas ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ju sqarojmë se:

Në Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 31, pika 1 është përcaktuar se: *Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur arrihet moshë dhe periudha e sigurimit që kërkohet në vite për secilën kategori, e përcaktuar në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993.*

Ju jeni e datëlindjes 07.02.1956 dhe sipas nenit 92, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, moshë dhe periudha e sigurimit e kërkuar për të përfituar pension pleqërie, me periudhë të plotë sigurimi është:

- moshë 60 vjeç e 4 muaj dhe periudha e sigurimit 35 vite e 8 muaj.

Moshën për të përfituar pension pleqërie e keni plotësuar më datën 07.06.2016, por nuk keni patur kushtin minimal prej 15 vitesh periudhë sigurimi për përfitim dhe pensioni ju është refuzuar.

Meqënëse ka kaluar një kohë e gjatë nga plotësimi i moshës për pension dhe ju nuk keni ndërmarrë hapat administrative ligjor për njohjen e vjetërsisë me dokumentacion të djegur, duhet të aplikoni për pension social në momentin që plotësoni moshën 70 vjeç.

Faleminderit për mirëkuptimin.